



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe nenit 15 pika 15.1.2.3 dhe 15.4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Nr.04/L-174, Vendimit për Dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, Nr.14/3306/1-ZSP/120/14 të dt 30.06.2014, Vendimit për dhënie të Pëlqimit në Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021 të Klinës, Nr.5835-2/14 të dt. 05.01.2015 nga MMPH, kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të dt.04.12.2014, Raportit të Punës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës me theks të veçantë në shqyrtimin publik janar 2014 me 06, Nr.350-3251/2014 të dt.13.06.2014, Raportit të Debatit me Publikun të dt. 10.12.2012- shkurt 2013, me rekomandimet e KPF të dt.15.12.2014 dhe të dt.08.06.2015, si dhe Rekomandimit të dt.21.08.2015 nga Komisioni ndërmnistror MMPH dhe MAPL për rishqyrtim të vendimit për miratim të Planit Zhvillimor Komunal të dt.19.06.2015 01Nr.06-4047/15, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të radhës për vitin 2015 të mbajtur më 25.09.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për Rishqyrtimin dhe miratimin e Planit Zhvillimor Komunal – PZHK 2014-2021

I

MIRATOHËT Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës për periudhën 2014-2021, pas rishqyrtimit të vendimit të miratuar të Kuvendit Komunal për Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021, me nr. 01Nr.06-4047/15 të dt.19.06.2015, duke hequr piken 4 të atij vendimi sipas rekomandimit të komisionit ndërmnistror MMPH-MAPL lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

II

Plani si në pikën një të këtij Vendimi është një Plan Strategjik multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjate të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor.

Plani përfshin: planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë se paku tetë (8) vjeçare.

III

Plani Zhvillimor Komunal përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kompetent është Drejtoria e Urbanizmit dhe MM.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb - faqen zyrtare të Komunës, kjo në kuptim të nenit 18 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale.

V

Me këtë Vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria komunale e Urbanizmit dhe MM, MAPL, Kompania Urban Plus në Prishtinë përmes Drejtorisë, një kopje për ueb-faqen e Komunës, një kopje mbetet në Shërbimin për Punë të Kuvendit dhe një për Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 96-537/2015
Klinë, më 25.09.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të radhës, të mbajtur me 25.09.2015, Rishqyrtoi vendimin e Kuvendit Komunal për Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021, me nr. 01Nr.06-4047/15 të dt.19.06.2015, duke hequr pikën 4 të këtij vendimi sipas rekomandimit të komisionit ndërmnistror MMPH-MAPL me arsyen që ky vendim është për miratim të Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021 e jo për ndryshime dhe plotësime të PZHK (ku në vendimin e dt.19.06.2015 në pikën 4 ishin të futura në këtë Plan edhe dy parcelat- që janë në procedim tani për ridestnim të pronave që të dyja në tokë ndërtimore për ndërtim të Xhamisë në Kpuz dhe Kishës në Deiq).

Andaj Vendimi i KK-Klinë i dt.25.09.2015 është vendim për miratim të Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021 dhe dokumentacionin me CD-en PZHK-Klinë, si me poshtë e ka të bashkangjitur me vendimin e miratuar me dt.19.06.2015.

1. Kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit të vitit 2010 për Inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.
2. Vendimit të Kuvendit Komunal, 01Nr.350-1539/10 të dt.05.05.2010, për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.
3. Vendimit për Dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, Nr.14/3306/1- ZSP/120/14 të dt 30.06.2014,
4. Vendimit për dhënie të Pëlqimit në Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021 të Klinës, Nr.5835-2/14 të dt. 05.01.2015 nga MMPH,
5. Kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe MM për miratim të Vendimit për PZHK nga Kuvendi Komunal - 01, Nr.351-5298/14 të dt.04.12.2014,
6. Raportit të Debatit me Publikun të mbajtur me 10.12.2012 deri në shkurt 2013,
7. Preferencave dhe rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa të dt.15.12.2014 dhe 08.06.2015.